



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Testimi paraprak 2018

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

PJESA I

Projektet në shkollë

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë

Pyetja 7 : 2 pikë

- Projektet në grup nuk zhvillojnë aftësitë e nxënësve dhe nuk i përgatisin ata për jetën e vërtetë.
- Janë më pak përfituese për nxënësit.
- Angazhimi i pjesëmarrësve është i rrallë.
- etj

Argumentet janë në paragrafët 2-3-4

2 pikë Nëse identifikon dy argumente në mbështetje të tezës.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një argument në mbështetje të tezës..

Në përgjigjen e dhënë, nxënësi mund ta marrë argumentin si fjali të gatshme nga teksti ose ta perifrazojë.

Pyetja 8 : 3 pikë

- Kundërteza: Projektet në grup janë të dobishme.
- Mbrojtësit: mësuesit
- Argumenti: I përgatisin nxënësit për “botën e vërtetë”, sepse i mësojnë të bashkëpunojnë me të tjerët.

1 pikë Nëse gjen kundërtezën

DHE

1 pikë Nëse gjen mbrojtësit e kundërtezës.

DHE

1 pikë Nëse gjen një argument në mbrojtje të saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **2 pikë**

Përdorimi i vetës së parë njëjës:

- Në rastin e parë për t'u pozicionuar, prezantuar pozicionin që ka pro ose kundër, për të personalizuar problemin, për ta bërë më të besueshëm tek lexuesi (*Për mendimin tim...*).
- Në rastin e dytë: për të ilustruar nga përvoja vetjake problemin që po trajton (*Unë, ashtu si shumë të tjerë...*).

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e përdorimit të vetës së parë njëjës në rastin e parë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e përdorimit të vetës së parë njëjës në rastin e dytë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë**

- Koha e tashme.
- Karakteristike e teksteve argumentuese. Siguron gjithkohësinë.

1 pikë Nëse gjen kohën e foljes në të cilën është shkruar teksti.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e përdorimit të kësaj kohe.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë**

- Në përmbyllje të kësaj pjese autori risjell në vëmendje pozicionin e tij kundrejt problemi që po trajton.
- Ky mendim vjen në formën e përfundimit dhe është shumë i shkurtër.

1 pikë Nëse tregon se në ç'përfundim arrin autori në fund.

DHE

1 pikë Nëse tregon se ç'të veçantë ka kjo mbyllje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

TESTA II

EPOSI I KRESHNIKËVE - "Martesa e Halilit" (fragment)

Pyetja 12	C	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë

Pyetja 16 3 pikë

Model përgjigjeje

➤ Është një bukuri në lëvizje, plot jetë, në zhvillim e sipër. Rapsodi ka nxjerrë në pah detaje (i ka theksuar) që japin përfytyrimin e lëvizjes. P.sh:

- qerpiku: si krahu i dallëndyshes- lëvizshmëria e qerpikut si e krahut të dallëndyshes.
- goja: si lulja që shpërthen, pra në zhvillim e sipër, në rritje, në lulëzim,
- fytyra: si molla në degë
- vetulla: si fiskaja- theksohet elasticiteti, eleganca, etj.

3 pikë Nëse argumenton në mënyrë të plotë bukurinë në lëvizje të Tanushës bashkë me dy ose me shumë nga detajet më domethënëse.

2 pikë Nëse argumenton në mënyrë të plotë bukurinë e Tanushës të dhënë në lëvizje bashkë me 1 detaje.

OSE

1 pikë Nëse vetëm e shpjegon por nuk përmend asnjë detaj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 17 2 pikë

1 pikë po ta fikin: shqetësimi lidhet vetëm me Mujin. Ty po ta fikin derën.

1 pikë po na koritin: shqetësimi lidhet me të gjithë fisin (përfshi edhe Mujin). Shqetësimi bëhet i përbashkët në rastin e dytë, në krahasim me vargun e mësipërm.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **2 pikë**

- 1 pikë** Rapsodi është fokusuar më shumë në portretin fizik të vajzës.
- 1 pikë** Sepse, për mendësinë popullore, më e rëndësishme është bukuria fizike.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 19 **2 pikë**

- Bukuria e Tanushës është aq e madhe, sa për ta përshkruar duhen mbledhur shumë elementë e objekte nga më të bukurit e natyrës.
- OSE**
- Bukuria e Tanushës bëhet objekt krahasimi me bukurinë e përsosur të natyrës (me elementet më të bukura të saj); kështu bukuria njerëzore ngrihet në shkallë më të lartë.

Figura e stilistikës: Krahasimi

- 1 pikë** Nëse përcakton qëllimin e rapsodit.
- DHE**
- 1 pikë** Nëse gjen figurën e stilistikës.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 **2 pikë**

- 1 pikë** **fonetik:** a-hundore –ë gja-gjë, ma-më, zanë-zënë
- OSE** ue-ua: martue-martuar
- 1 pikë** **leksikor:** çetinat-pishat
- OSE** bash-tamam
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Tetja 21

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin (argumentin/argumentet)
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.**1 pikë** **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.